



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 36/2024 regjistër (JR)
Datë 09.09.2024

Nr. 17 i vendimit
Datë 12.02.2026

V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Sokol Çomo	Kryesues
Rezarta Schuetz	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Ina Rama	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare

shpalli sot, më datë 12.02.2026, ditën e enjte, në orën 16:00 në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar z. Ferdinando Buatier de Mongeot, me sekretare gjyqësore Arjela Vllaçaj, vendimin për çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

ANKUES: Komisionere Publike, Irena Nino.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 778, datë 28.06.2024 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit znj. Vjollca Spahiu.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancën gjyqësore publike të zhvilluar në datat 04.02.2026 dhe 11.02.2026, me praninë e palëve, në përputhje me parashikimet e nenit 65, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016), analizoi pretendimet e ngritura në ankim nga Komisionerja Publike Irena Nino dhe konkluzionet përfundimtare të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, i cili përfundimisht kërkoi *lënien në fuqi* të vendimit nr. 778, datë 28.06.2024 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, e pasi analizoi parashtrimet dhe konkluzionet përfundimtare të subjektit të rivlerësimit, e cila kërkoi përfundimisht mospranimin e ankimit të Komisionerit Publik dhe pushimin e shqyrtimit të çështjes (JR) nr. 36/2024, datë 09.09.2024, dëgjoi gjyqtaren relatores Rezarta Schuetz si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Në lidhje me rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Vjollca Spahiu, (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio* në zbatim të nenit 179/b, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe nenit 3, pika 16 të ligjit nr. 84/2016, për shkak të ushtrimit të funksionit si gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe formularin për vetë-vlerësimin profesional, në përputhje me nenin 31, pika 1, nenin 35, pika 1 dhe nenin 41, pika 1, të ligjit nr. 84/2016.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), ka administruar raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim, ILDKPKI), Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim, AKSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim, KLGj).
 - 2.1. ILDKPKI-ja, dërgoi pranë Komisionit raportin përfundimtar për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, sipas të cilit: (i) deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin; (ii) ka burime të ligjshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklaram të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
 - 2.1 AKSIK-ja, në përfundim të procesit të kontrollit të figurës të subjektit të rivlerësimit, ka përcjellë raportin e rishikuar të vlerësimit, përmes të cilit ka ndryshuar konstatimin fillestar për këtë subjekt, nga përshtatshmëri në *papërshtatshmëri* për vazhdimin e detyrës, pasi gjatë periudhës që subjekti ushtronte detyrën e gjyqtares, ka pasur dyshime se ka ushtruar ndikim të paligjshëm.
 - 2.2 KLGj-ja, pasi kreu vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përfundim të procedurës së kontrollit, i dërgoi Komisionit një raport të hollësishëm për subjektin e rivlerësimit.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Në përfundim të procesit të rivlerësimit kalimtar të kryer për të tria kriteret e rivlerësimit, Komisioni vendosi *konfirmimin në detyrë* të subjektit të rivlerësimit, në bazë të shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 58 të ligjit nr. 84/2016 dhe të pikës 1, të nenit 59 të po këtij ligji. Ky vendim u bazua në konkluzionin përfundimtar se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, nivel të besueshëm në kontrollin e figurës si dhe një nivel kualifikues të vlerësimit të aftësive profesionale. Arsyetimi i Komisionit përmbledhet në vijim:

3.1. Subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm *në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë*. Nga kontrolli i ushtruar mbi pasurinë njësi shërbimi, me sipërfaqe 53 m², ndodhur në Tiranë, nuk rezultuan indicie për çmimin e blerjes së pasurisë. Balanca negative prej (-) 397.547 lekësh që rezultoi në analizën financiare e kryer për të gjithë periudhën 1995 -- 2016, e shpërndarë në vitet 2003 dhe 2007 në vlera jo domethënëse, si edhe disa pasaktësi të konstatuara në deklarime, nuk mund të passjellë masën disiplinore të shkarkimit nga detyra, bazuar në parimin e proporcionalitetit.

3.2. Subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm *për kriterin e kontrollit të figurës*. Analiza e shpjegimeve të subjektit dhe dokumentacionit të administruar, nuk lë dyshime për kontakt të papërshtatshëm me subjektin e rivlerësimit. Në asnjë nga çështjet e shqyrtuara nuk kanë rezultuar veprime favorizuese. Për rrjedhojë, nuk verifikohet asnjë nga elementet për të ngritur dyshime për papërshtatshmëri në ushtrimin e detyrës së gjyqtarit.

3.3. Subjekti i rivlerësimit ka arritur nivelin minimal kualifikues në lidhje me kriterin e *vlerësimit të aftësive profesionale*. Komisioni nuk ka konstatuar mangësi profesionale, mosrespektim të të drejtave të palëve apo mangësi në arsyetimin e vendimeve të dhëna prej saj. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit vlerësohet me një nivel profesional bindshëm kualifikues.

III. Shkaqet e ankimit të Komisioneres Publike

4. Kundër vendimit të Komisionit ka ushtruar ankim Komisionerja Publike e cila vlerëson se evidentohen gjetje dhe rrethana ligjore e fakti, që e bëjnë të cenueshëm atë në tërësinë e tij. Në kërkimin përfundimtar të ankimit, Komisionerja Publike kërkon *ndryshimin* e vendimit dhe *shkarkimin nga detyra* të subjektit të rivlerësimit pasi ajo *nuk* arrin nivel të besueshëm për konfirmimin në detyrë.

4.1. Në vlerësimin e Komisioneres Publike, subjekti i rivlerësimit *nuk* arriti nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, pasi ka bërë deklaram të pasaktë e të pamjaftueshëm të pasurisë dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme. Për rrjedhojë subjekti ndodhet në kushtet e nenit 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016.

4.2. Ndërsa në vlerësimin tërësor të procedurave, Komisionerja Publike çmon se problematikat e konstatuara në veprimet e subjektit të rivlerësimit me qëllimin përfitimin e një kredie me kushte tregtare, nga një bankë e nivelit të dytë, e vendosin subjektin në kushtet e cenimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, me pasojë zbatimin e nenit 61, pika 5 të ligjit nr. 84/2016.

4.3. Ankimi ka për fokus disa aspekte të *kontrollit të pasurisë*, e konkretisht: (i) një njësi shërbimi me sipërfaqe 53 m², ndodhur në Tiranë dhe (ii) një apartament me sipërfaqe 75 m² ndodhur po në Tiranë. Pretendimet e Komisioneres Publike për këto dy pasuri janë:

4.3.i. Për pasurinë *njësi shërbimi me sipërfaqe 53 m², ndodhur në Rrugën “{***}”, Tiranë*, Komisionerja Publike pretendon se dy kontratat e sipërmarrjes për këtë pasuri, të datave 18.03.2005 dhe 19.05.2005 (të hartuara pranë të njëjtës notere¹) me rekuizita, data, vlera dhe modalitetet e pagesash të ndryshme si edhe kontrata e qirasë datë 17.05.2005 me palë familjarë të subjektit -- akte të cilat sikurse pohuar edhe nga vetë subjekti, janë nënshkruar vetëm për t’iu paraqitur bankës në funksion të përfitimit të kredisë -- konsiderohen si veprime me elemente të *fiktivitetit* në kuptim të nenit 92 të Kodit Civil, të kryera për shmangien e zbatimit të normave ligjore që rregullojnë përfitimin e kredive bankare. Këto zgjedhje të subjektit të rivlerësimit, parë nën dritën e qëllimit të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve për rikthimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, *cenojnë* besimin e publikut te drejtësia, në kuptim të nenit 61, pika 5 të ligjit nr. 84/2016.

4.3.ii. Po ashtu, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të ndodhen në kushtet e nenit 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016, pasi *nuk* mbulojnë me burime të ligjshme, pagesën e *këstit të parë* në shumën 20.000 euro dhe kanë *mungesë* të burimeve të ligjshme për vitin 2007, në vlerën 1.195.905 lekë. Në mënyrë më specifike, Komisionerja Publike pretendon se sikurse përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes të datës 18.03.2005, kësti i parë prej 20.000 eurosh është paguar në momentin e nënshkrimit të këtij akti. Këto veprime janë konfirmuar me kontratën e shitjes. Bazuar në jurisprudencën e Kolegjit, kontratat e shitblerjes për pasuritë e paluajtshme kanë forcën e ligjit për palët dhe nuk mund të ndryshohen/kontestohen me akte të prodhuara përgjatë dhe në funksion të procesit të rivlerësimit kalimtar të subjekteve. Përmbajtja e kontratës noteriale të datës 18.03.2005, duhet të konsiderohet si referim ligjor për sa parashikohet në të, më së paku, për momentin e pagesës së këstit të parë në shumën 20.000 euro. Në vijim të kësaj analize, Komisionerja Publike pretendon se subjekti i rivlerësimit *nuk* mbulon me të ardhura të ligjshme pagesën e *këstit të parë* të apartamentit në shumën 20.000 euro;

4.3.iii. Subjekti i rivlerësimit rezulton me *pamjaftueshmëri* financiare prej (-) 1.195.905 lekësh për vitin 2007. Në analizën financiare *nuk* duheshin përfshirë të *ardhurat nga qiraja* e apartamentit në Tiranë, të cilat nuk plotësojnë kriteret e ligjshmërisë sipas nenit D, pika 3, të Aneksit të Kushtetutës, në kushtet që tatimet mbi të ardhurat e deklaruar, janë paguar pas dorëzimit të deklaratës *Vetting*, për efekt të procesit të rivlerësimit. Po ashtu, subjekti *nuk* provoi me dokumentacion, të ardhurat/kompensimet e pretenduara si të përfituara nga bashkëshorti i saj për shkak të statusit të ushtarakut. Për rrjedhojë, *shpenzimet e jetesës* për vitin 2007, duhen llogaritur sipas standardit të Kolegjit, në shumën 235.968 lekë për secilin anëtar të familjes.

4.3.iv. Për pasurinë *apartament me sipërfaqe 75 m², në Tiranë*, me çmim 3.000.000 lekë, Komisionerja Publike pretendon se subjekti i rivlerësimit ka kryer *deklarim të pasaktë* dhe jo në përputhje me nenin 4 të ligjit nr. 9049/2003, si përsa i përket kohës kur është kryer blerja, ashtu edhe mosdeklarimit të burimit të kësaj pasurie. Konkretisht, sipas Komisioneres Publike, subjekti ka deklaruar këtë pasuri në deklaratën për vitin 2004, ndonëse ishte blerë që në vitin 2003 por, deklaruar në vitin 2004. Deklarimet periodike

¹ Noterja M. Sh. konfirmon vetëm kontratën e parë të datës 18.03.2005.

vjetore shërbejnë si një burim i rëndësishëm prove në procesin e rivlerësimit, në kuptim të nenit 32, pika 5 të ligjit nr. 84/2016.

4.3.v. Subjekti nuk provoi të kundërtën e barrës së provës për *mungesën* e burimeve të ligjshme të konstatuar nga Komisioni në shumën (-) 517.039 lekë, pasi nuk paraqiti dokumentacion për të provuar kompensimet e bashkëshortit të saj gjatë ushtrimit të detyrës si ushtarak, në funksion të reduktimit të shpenzimeve të jetesës. Po ashtu, subjekti nuk provoi të kundërtën përse i përket *pamjaftueshmërisë* financiare të vitit 2006 në vlerën (-) 252.963 lekë, rezultat që vjen për shkak të mospërfshirjes në analizën financiare të të ardhurave nga qiradhënia e apartamentit në Tiranë për vitin 2006 dhe i llogaritjes të shpenzimeve të jetesës sipas standardit të ILDKPKI/INSTAT.

IV. Kundërankimi i subjektit të rivlerësimit

5. Subjekti i rivlerësimit, ka ushtruar të drejtën e kundërankimit, nëpërmjet apelit kundërshtues ndaj ankimit të mësipërm të Komisioneres Publike. Përmes këtij akti të dorëzuar në Komision, subjekti ka kërkuar mospranimin e ankimit dhe lënien në fuqi të vendimit të Komisionit.

V. Pretendime dhe akte të depozituara nga palët gjatë gjykimit në Kolegjin e Posaçëm të Apelit

6. Përpara zhvillimit të seancës gjyqësore publike të datës 04.02.2026, në Kolegji u depozituan parashtrime dhe akte përkatësisht nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme² dhe nga subjekti i rivlerësimit³. Aktet e depozituara në Kolegji, iu njoftuan respektivisht Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, subjektit të rivlerësimit dhe Vëzhguesit Ndërkombëtar.

VI. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. *Mbi procesin gjyqësor në Kolegji*

A/i. *Juridiksioni i Kolegjit*

7. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja me objekt shqyrtimi kundërshtimin e vendimit të Komisionit bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit. Trupi gjykues i Kolegjit, me përbërjen si në pjesën hyrëse të këtij vendimi, është rezultat i shortit të zhvilluar në datën 12.09.2024, i cili është publikuar në internet në faqen zyrtare të Kolegjit.

² Përmes shkresës nr. {***} prot./A.Xh, datë 28.01.2026, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, depozitoi aktet: Parashtrime me shkrim; autorizimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme datë 28.01.2026, për përfaqësimin e çështjes në seancë publike nga prokurori Adnan Xholi.

³ Në datën 20.01.2026 nëpërmjet email-it dhe fizikisht në datën 21.01.2026, subjekti i rivlerësimit depozitoi: Parashtrësia dhe kërkesë për riceljen e hetimit e marrjen e akteve në cilësinë e provës; Analizë financiare; shkresë "kthim përgjigje", datë 08.09.2025, lëshuar nga subjekti "{***}" ShPK së bashku me praktikën shoqëruese; shkresa nr. {***} prot., datë 29.07.2025 lëshuar nga Qendra e Personel Rekrutimit pranë Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura; shkresa nr. {***} prot., datë 27.11.2025 lëshuar nga Drejtori i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura së bashku me praktikën shoqëruese.

A/ii. Legjitimimi i ankuesit

8. Komisionerja Publike legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

A/iii. Forma dhe mënyra e shqyrtimit të çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelit

9. Shqyrtimi i ankimit ndaj vendimit nr. 778, datë 28.06.2024, të Komisionit, duke qenë se është ushtruar nga Komisionerja Publike, u zhvillua në seancë gjyqësore publike, në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Në seancën gjyqësore të datës 04.02.2026, për shkak të mbarimit të mandatit të Komisionerëve Publikë dhe bazuar në parashikimet e nenit 179/b, pika 8 e Kushtetutës dhe të nenit 199, paragrafi i 2-të i Kodit të Procedurës Civile, trupi gjykues i Kolegjit vendosi kalimin procedural nga Komisioneri Publik tek Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme. Ky i fundit, në bazë të autorizimit të datës 28.01.2026, u përfaqësua nga prokurori Adnan Xholi.

9.1. Në seancën gjyqësore në Kolegji, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, në parashtrimet e tij deklaroi në linjë me ankimin e Komisioneres Publike, sikurse referuar më sipër. Konkretisht, në mënyrë të përmbledhur, ai u shpreh se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklaramit të pasaktë e të pamjaftueshëm të pasurisë, si dhe me mungesë të burimeve financiare të ligjshme, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit 84/2016. Veprimet juridike fiktive të ndërmarra prej saj me qëllim përfitimin e një kredie tregtare, e vendosin subjektin në kushtet e cenimit të besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë. Po ashtu, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme parashitroi edhe që ndërsa subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të paraqesë prova dhe argumente shtesë në kundërshtim të ankimit, referuar gjendjes që janë aktet, kërkohet ndryshimi i vendimit objekt ankimi të Komisionit dhe shkarkimi nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

9.2. Subjekti i rivlerësimit parashitroi se shkaqet e ankimit janë të pabazuara në ligj e në prova, të paargumentuara, jo racionale dhe në mospërputhje me dispozitat e nenit 61, pika 3 dhe 5 të ligjit 84/2016. Në mbështetje të pretendimeve të saj, subjekti i rivlerësimit rikonfirmoi aktet e depozituara në Kolegji⁴ duke kërkuar edhe pranimin e tyre në cilësinë e provës.

9.3. Bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 45 dhe 49, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues i Kolegjit vendosi që të marrë në cilësinë e provës aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit. Pasi palët deklaruan se nuk kanë kërkesa të tjera procedurale dhe shprehën dakordësinë e tyre për mbylljen e hetimit gjyqësor, trupi gjykues i dha fund hetimit gjyqësor. Në seancën e datës 11.02.2026 palët dhanë konkluzionet përfundimtare.

9.4. Në këtë fazë, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, ndryshe nga sa ishte parashtruar në ankim dhe në parashtrimet në seancën gjyqësore publike të datës 04.02.2026, kërkoi *lënien në fuqi të vendimit* objekt shqyrtimi që konfirmoi subjektin në detyrën e gjyqtarës bazuar në parimin e

⁴ Referuar më sipër në poshtëshënimin nr. 2 të këtij vendimi.

proporcionalitetit. Sipas parashtrimeve të tij, gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar në Kolegj, nëpërmjet provave të reja dhe shpjegimeve bindëse e të arsyeshme, subjekti i rivlerësimit provoi të kundërtën e ankimit për kriterin e pasurisë. Arsyetimi mbi të cilin ka bazuar këtë kërkim, parashtrohet si vijon:

9.4.i. Lidhur me pasurinë *njësi shërbimi [me sipërfaqe 53 m², ndodhur në rrugën “{***}”]*, Tiranë, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme potencoi se në një vlerësim tërësor të situatës faktike dhe ligjore dhe duke marrë në konsideratë shpjegimet e dhëna nga subjekti dhe aktet e depozituara prej saj gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, rezultoi e provuar se shuma totale e paguar për këtë pasuri është 63.600 euro, dhe se pagesa është kryer në dy këste, përkatësisht 40.000 euro në vitin 2005 dhe 23.600 euro në vitin 2010. Për rrjedhojë, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme e çmon bindës deklarin e subjektit lidhur me datat, vlerat dhe mënyrën e kryerjes së pagesave për blerjen e kësaj pasurie në vlerën 63.600 euro.

9.4.ii. Subjekti ka qenë konsistent në të gjitha deklarinimet e saj për këto detaje të krijimit të pasurisë dhe janë konfirmuar edhe nga shoqëria ndërtuese me shkresën e datës 13.03.2023. Në këtë shkresë referohet edhe pagesa e kryer sipas dy mandateve të arkëtimit që i përkasin datave 30.06.2005⁵ dhe 07.06.2010 për këstet 40.000 dhe 23.600 euro. Këto këste e kjo mënyrë pagese u konfirmua gjatë gjykimit në Kolegj edhe nga shkresa e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë me nr. {***} prot., datë 22.08.2025, dhe aktet bashkëlidhur, depozituar nga subjekti gjatë procesit gjyqësor në Kolegj.

9.4.iii. Edhe kontratat e ngjashme për pasuri të shitura në të njëjtin objekt në vitin 2005, paraqitur nga shoqëria ndërtuese, referojnë një vlerë për metër katror me të njëjtin çmim me atë të paguar nga subjekti i rivlerësimit [1.200 euro/m²]. Po ashtu, çmimi me të cilin subjekti dhe personi i lidhur kanë blerë njësinë është konsiderueshëm më i lartë krahasuar me të dhënat e Entit Kombëtar të Banesave për tregun e lirë të apartamenteve në Tiranë, për vitin 2005. Konkretisht, ndërsa vlera totale për një sipërfaqe prej 53 m² do të llogaritej në vlerën rreth 4.000.000 lekë sipas çmimeve të referencës, vlera prej 63.600 euro, paguar nga subjekti e personi i lidhur është ekuivalenti i rreth 8.000.000 lekë.

9.4.iv. Lidhur me *pamjaftueshmërinë* e konstatuar për vitin 2007, bazuar në informacionin e përcjellë nga Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, depozituar nga subjekti gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme e çmon të arsyeshëm pretendimin e subjektit për reduktimin e shpenzimeve të jetesës së bashkëshortit për periudhën respektive. Këto akte konfirmojnë trajtimin me ushqim dhe veshje të bashkëshortit të subjektit gjatë kohës kur ai ka qenë ushtrak aktiv, deri në vitin 2010. Për rrjedhojë, nisur nga pesha që zënë këto zëra në shpenzimet mujore të konsumit, sipas të dhënave statistikore të INSTAT, duke aplikuar një reduktim prej 50% të shpenzimeve të jetesës për bashkëshortin e subjektit për vitin 2007, diferenca negative e konstatuar për këtë vit rezulton në shumën -1.077.921 lekë.

9.5. Lidhur me pasurinë *apartament me sipërfaqe 75 m², në Tiranë*, në konsideratë të shpjegimeve të subjektit, si dhe të akteve të depozituara prej saj gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme parashtroi se:

⁵ Arkëtuar në datën 13.07.2005 sipas Librit të arkës.

9.5.i. Pasaktësitë e konstatuara në deklaratat periodike të viteve 2003 dhe 2004, janë vetërregulluar më pas dhe nuk janë të një peshe që të sjellë penalizim për subjektin e rivlerësimit, nëse nuk shoqërohen me ndonjë pamjaftueshmëri domethënëse të burimit të krijimit.

9.5.ii. Sa i përket pamjaftueshmërive financiare për vitet 2003 dhe 2006, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme çmon se edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë përfitimin faktik të të ardhurave nga qiraja e apartamentit në Tiranë për periudhat përkatëse, si dhe ligjshmërinë e tyre për efekt të procesit të rivlerësimit. Për rrjedhojë, këto të ardhura nuk mund të konsiderohen si burime të ligjshme financiare për këto vite.

9.5.iii. Ndërsa, sa i përket pretendimit për reduktimin e shpenzimeve të jetesës së bashkëshortit, sikurse konstatuar e analizuar më sipër, duke reduktuar shpenzimet e jetesës për bashkëshortin e subjektit për periudhën 1995-2003 në 50%, sikurse rezulton nga analiza e kryer nga Komisioni, balanca negative në fund të vitit 2003 reduktohet në vlerën (-) 187.583 lekë, ndërsa balanca negative e vitit 2006 reduktohet në vlerën (-) 198.184 lekë.

9.6. Në përfundim, balanca negative totale e burimeve të ligjshme është në shumën (-) 1.463.688 lekë, e shpërndarë në disa vite. Kjo situatë ka ardhur kryesisht si pasojë e pamundësisë së subjektit për të provuar përfitimin faktik dhe ligjshmërinë e të ardhurave nga qiraja e apartamentit në Tiranë për vitet e pretenduara, megjithëse ekzistojnë indicie që një pjesë e këtyre të ardhurave mund të jene përfituar në vitet e pretenduara.

9.7. Sa më sipër, referuar jurisprudencës së konsoliduar të Kolegjit, bazuar në parimin e proporcionalitetit, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme vlerëson se balanca negative e konstatuar nuk është e mjaftueshme për të konkluduar që subjekti gjendet në kushtet e një e deklarami të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë nën dritën e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Po ashtu, në një vlerësim tërësor të rrethanave që lidhen me veprimet e bashkëshortit të subjektit në lidhje me përfitimin e kredisë tregtare, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme çmon se këto rrethana nuk janë të tilla dhe nuk janë të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e cenimit të besimit të publikut të sistemi i drejtësisë, sipas nenit 61, pika 5, të ligjit nr. 84/2016.

10. Pasi u njoh me këtë qëndrim të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, përpos konkluzioneve të saj me shkrim, subjekti i rivlerësimit u shpreh që e vlerësoi atë të drejtë, sikurse edhe kërkimin e tij përfundimtar. Përfundimisht, subjekti i rivlerësimit i kërkoi Kolegjit mospranimin e ankimit të Komisionerit Publik dhe pushimin e shqyrtimit të çështjes që i përket rivlerësimit të saj.

B. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

11. Pasi mori në konsideratë sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit konstaton që kërkimi përfundimtar i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, analizuar në harmoni me rrethanat procedurale të kësaj çështje, duhet të konsiderohet se ka barazuar efektet me ato të heqjes dorë nga ankimi. Në kushtet që Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme kërkoi *lënien në fuqi* të vendimit të Komisionit në bisedimet përfundimtare, trupi gjykues i Kolegjit e vlerëson këtë kërkim të njëjtë me ushtrimin e institutit të heqjes dorë nga ankimi. Për pasojë, Kolegji mbetet pa *ratio* për shqyrtimin e çështjes.

11.1. Kërkimi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme për lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi është një alternativë që kushtëzon vendimmarrjen e Kolegjit, cilido që të jetë konkluzioni. Në këtë mënyrë, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, si pala që mbart tagrat e ankuesit, duke pranuar vendimmarrjen e Komisionit, *de facto*, nuk krijon një alternativë tjetër që kontrolli dhe vendimmarrja e Kolegjit mbi vendimin objekt shqyrtimi, të jenë efektive. Vendimi i Kolegjit, për t'ia nënshtuar kontrollit vendimin e Komisionit, dhe duke vendosur në konkluzion lënien në fuqi, në këtë rast, mbetet thjesht një mjet tërësisht formal, përpos edhe pa *ratio*. Interesi i ligjshëm i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, duke mbështetur përfundimisht vendimin objekt ankimi, vlerësohet nga trupi gjykues se nuk mund të interpretohet përveçse si një heqje dorë nga ankimi dhe një heqje e të drejtës/detyrës së Kolegjit për t'ia nënshtuar kontrollit. Vendimi i Komisionit, në rrethanat që paraqiten në këtë moment procedural, nuk mund t'i nënshtrohet një hetimi efektiv, pasi në thelb, ushtrimi procedural është tërësisht teorik, e i pamundur të ndryshojë vendimin objekt ankimi.

11.2. Kërkimi përfundimtar për lënien në fuqi të vendimit objekt ankimi, u analizua në drejtim të interesit të ligjshëm për të vijuar procesin përpara gjykatës. Mungesa e një interesi të ligjshëm nënkupton që Kolegji do të përfshihej në çështje e do t'i përgjigjej pyetjeve tërësisht *hipotetike*, zgjidhja e të cilave nuk ka mundësi të sjellë pasoja ligjore⁶. Për këtë shkak, në kuadrin mbi të cilin është ngritur dhe funksionon procesi i rivlerësimit kalimtar, trupi gjykues vlerëson se në rastin konkret nuk ka një objekt për të shqyrtuar e për të cilin mund të arrijë në një konkluzion, pasi interesi publik, që mbrohet nga Komisioneri Publik/Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, sipas pikës 2 të nenit C të Aneksit të Kushtetutës, ka rënë.

11.3. Në këto kushte, pas reflektimit të konkluzioneve të sipërcituara, nën dritën e premisë që kërkimi përfundimtar për lënie në fuqi të vendimit, mund të barazohet nga pasojat me heqjen dorë nga ankimi prej titullarit që mban këtë të drejtë, sipas parimeve procedurale civile, të cilat normojnë edhe procesin e rivlerësimit në zbatim të pikës 6⁷ të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 dhe pikës 2⁸ të nenit 1, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, Kolegji nuk ka më lëndë të shqyrtojë çështjen për të cilën është vënë në lëvizje.

12. Në funksion të qartësimit të pozitës procedurale të subjektit të rivlerësimit, në raport me procesin e rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016, konsideruar natyrën e posaçme të këtij procesi, Kolegji gjen me vend të deklarojë edhe efektin ligjor që prodhon kjo vendimmarrje kundrejt vendimit të Komisionit. Në këtë kuptim, trupi gjykues i Kolegjit vëren se vendimi objekt ankimi i Komisionit do të konsiderohet se merr formë të prerë në momentin që Kolegji merr vendimin për pushimin e shqyrtimit të kësaj çështjeje, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, nenit 1, pika 2 dhe 44 e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar dhe nenit 451, shkronja “b” dhe 463 të Kodit të Procedurës Civile.

⁶ Gjykata Evropiane e Drejtësisë, në çështjen T-19/06, *Mindo Srl kundër Komisionit Evropian*, paragrafi 90, në <https://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?jsessionid=0F113F2007668B7AB5B0384B1B9B572B?text=&docid=110401&pageIndex=0&doclang=EN&mode=lst&dir=&occ=first&part=1&cid=6563354>

⁷ Kur është rasti, institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë edhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative ose në ligjin “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, nëse këto procedura nuk janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji.

⁸ Dispozitat e këtij ligji plotësohen me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile, me përjashtim të rasteve dhe për aq sa ky ligj nuk parashikon ndryshe.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në pikën 6, të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 451 shkronja “b” dhe nenin 463 të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

1. Pushimin e shqyrtimit të çështjes (JR) nr. 36/2024, në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, që i përket ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 778, datë 28.06.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit Vjollca Spahiu.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, sot, më datë 12.02.2026.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

RELATORE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

KRYESUES

Sokol ÇOMO

nënshkrimi